



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. 4793 Prot.

Elbasan, më 25.08.2026

VENDIM

Nr. 706 datë 25.08.2026

“Për përcaktimin e detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave”

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të aktivitetit administrativ të administratës së Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit të saj, bashkërendimin e aktivitetit të strukturave në realizimin e funksioneve dhe shërbimeve publike, bazuar në nenet 8, 9, 59 e 64 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), në nenet 28 e 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i R.Sh.” (i ndryshuar), në ligjin nr. 10296 datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar) dhe në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar);

VENDOSA:

- 1) Zv/kryetari i Bashkisë, **z. IRLAND SINA**, është përgjegjës për drejtimin, organizimin e punës, ndarjen e detyrave, kontrollin dhe monitorimin e aktivitetit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit Ekonomik, Kulturës e Turizmit, Drejtorisë së Përgjithshme të Kulturës dhe Sportit si dhe strukturave vartëse të tyre.
- 2) Në funksion të realizimit të përgjegjësi si mësipër, zv/kryetari z. Irland Sina, i delegohen kompetencat si mëposhtë:
 - ***Është “Nëpunës Autorizues” për menaxhimin e buxhetit dhe financave vendore, Koordinator i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe Koordinator i Riskut;***
 - ***Kontrollon dhe nënshkruan të gjithë korespondencën e krijuar dhe aktet e nevojshme administrative, në funksion të realizimit të përgjegjësi të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi;***
 - ***Kur, për realizimin e funksioneve të përcaktuara në këtë vendim, është e nevojshme lidhja e kontratave apo marrëveshjeve, në të cilat Bashkia është palë, ato mund të nënshkruhen nga zv/kryetari me autorizim të posaçëm të Kryetarit të Bashkisë;***
 - ***Kontrollon, miraton e nënshkruan materialet që paraqiten në Këshill Bashkiak, si relacione, projektvendime etj., që kanë lidhje me ushtrimin e përgjegjësi të***

përcaktuara në këtë vendim si dhe merr masat e nevojshme për zbatimin e vendimeve të këtij këshilli;

- 3) Aktet dhe shkresat zyrtare, të dala në zbatim të kompetencave të sipërcituara, do të jenë njëloj të detyrueshme për Administratën e Bashkisë dhe njësitë vartëse të saj.
- 4) Ushtrimi i këtyre kompetencave do të bëhet nga data _____.____.2026 deri në një urdhër të dytë.
- 5) Zv/kryetari, z. Irland Sina, nuk mund të nëndelegojë këto kompetenca tek punonjës apo struktura të tjera të Bashkisë.
- 6) Zv/kryetari, z. Irland Sina, do të raportojë periodikisht, por jo më rrallë se një herë në muaj, për realizimin e detyrave të përcaktuara në këtë vendim.
- 7) Vendimi nr. 450 datë 10.6.2026 i Kryetarit të Bashkisë dhe të gjitha aktet e tjera të delegimit të kompetencave për zv/kryetarin, z. Irland Sina, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
- 8) Ngarkohen zv/kryetari, z. Irland Sina, dhe Administrata e Bashkisë me zbatimin e këtij vendimi si dhe Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit dhe Medias, me publikimin e tij.
- 9) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Bashkisë.

KRYETARI

Gledian Llatja

